




KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
Prishtinë - Prishtina



KOLEGJI " PJETËR BUDI" - PRISHTINË

RREGULLORE MBI KRITERET PËR MUNDËSINË E SHKOLLIMIT FALAS DHE PËRGJEGJËSITË PËR PËRFITUESIT E SHKOLLIMIT FALAS (BURSISTËVE)

Prishtinë, 2020



Në bazë të nenit 21 të Statutit, Bordi Drejtues i të Kolegjit "Pjetër Budi", me datën 30.12.2020, miratoi kete:

RREGULLOREN
MBI KRITERET PËR MUNDËSINË E SHKOLLIMIT FALAS DHE PËRGJEGJËSIT PËR
PËRFITUSIN E SHKOLLIMIT FALAS (BURSISTIN)

I – DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen llojet, kriteret, kushtet, detyrat, përgjegjësit e përfituesit të shkollimit falas (bursistit), procedura e ndarjes së bursave për studime universitare themelore (Baçelor) dhe procedura apeluese.

II – LLOJET, KRITERËT DHE KUSHTET PËR SHKOLLIMIN FALAS (BURSË)

Neni 2

- 2.1. Kolegji ndanë bursa për studentë vetëm për studime themelore (Baçelor).
- 2.2. Kolegji ndanë bursa:
 - 2.2.1. Të plota dhe
 - 2.2.2. Bursa parçiale.

Neni 3

Llojet e bursave

- 3.1. Kolegji ndanë:
 - 3.1.1. Bursa meritore;
 - 3.1.2. Bursa për raste sociale;
 - 3.1.3. Bursa për persona me aftësi të kufizuara.

Neni 4

Kriteret për bursë meritore

- 4.1. Për bursë meritore universitare, studentët në studime themelore (baçelor) duhet t'i plotësojnë dy lloje të kritereve:
 - 4.1.1. Kriteret akademike dhe
 - 4.1.2. Kriteret teknike administrative
- 4.2. Në kriteret akademike bëjnë pjesë këto kushte:
 - Të kenë përfunduar vitin e parë të studimeve;



KOLEGJI - COLLEGE

PJETËR BUDI

Prishtinë - Prishtina

- Të kenë notën mesatare 9.00 ose më të lartë;
- Përfundimisht nga pika e më sipërme, studenti i cili ka treguar rezultate të mëdha shkencore (p.sh. ka publikuar punime në revista shkencore prestigjioze apo ka botuar monografi dhe libra të rëndësishme);
- Studenti duhet ta mbajë këtë notë edhe në vitin pasues nëse e fiton bursën;
- Të mos kenë vit të përsëritur;
- Botimi i ndonjë punimi në revista të huaja apo në revistën e Kolegjit;
- Prezantimi i punimeve në ndonjë konferencë apo seminar shkencor.

4.3. Në kriteret teknike administrative bëjnë pjesë këto kushte:

- Duhet të jenë të rregullt në ligjërata;
- Duhet të jenë të rregullt në aktivitetet e Kolegjit;
- Duhet të jenë aktivë në strukturat menaxheriale të studentëve;
- Të marrin pjesë në aktivitetet e organizuara nga studentët;
- Të respektojnë Kodin Etik të studentëve;
- Të kenë sjellje shembullore me stafin akademik dhe administrativ, etj.

Neni 5

Procedura e aplikimit dhe e fitimit të bursës meritore

5.1. Për ndarjen e bursave meritore Kolegji shpall konkurs në fillim të vitit akademik përkatës, përkatësisht me 1 tetor të çdo viti akademik.

5.2. Konkursi do të jetë i shpallur në afat prej 7 ditësh nga data e publikimit.

5.3. Shpallja e rezultateve bëhet me datën 20 tetor.

5.4. Të drejtë aplikimi për bursë meritore kanë Studentët të cilët i plotësojnë kushtet e përmendura në nenin 4 të kësaj Rregulloreje.

Neni 6

6.1. Me qëllim të përzgjedhjes së kandidatëve më të suksesshëm për fitimin e bursave meritore, studentët do t'i:

- nënshtrohen testit (provimit) me shkrim; dhe
- provimit me gojë.

Neni 7

7.1. Studentët të cilët përzgjidhen do të fitojnë bursë një vjeçare.

7.2. Studentët përfitues kanë të drejtë të aplikojnë sërish për bursë meritore nëse i plotësojnë kriteret.

Neni 8

Kriteret për bursë sociale

8.1. Me qëllim të mbështetjes për studentët të cilët kanë treguar rezultate në shkollimin e mesëm dhe nuk kanë mundësi financiare për vijimin e studimeve, Kolegji do të ndajë një numër të caktuar të bursave për këto kategori.

8.2. Numri i bursave për këtë kategori caktohet nga Bordi Drejtues në filli të çdo viti akademik përkatësisht në muajin shtator.



8.3. Për fitimin e bursave të kësaj kategorie, Kolegji shpall konkurs, në të cilin konkurs përcaktohen edhe kriteret e fitimit të bursave.

8.4. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë nxënësit e shkollave të mesme shtetas të Republikës së Kosovës të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme dhe që kanë përfunduar provimin e maturës shtetërore.

8.5. Kriteret bazë për fitimin e bursës sociale janë:

- Të kenë suksesin e shkëlqyeshëm në shkollën e mesme;
- Të jenë nën përkujdesje sociale të shtetit.

8.6. Bursat jepen për periudhë njëvjeçare me mundësi vazhdimi. Për të vazhduar bursa për vitet tjera akademike, studenti duhet të përmbushë këto kriteret:

- Të mbajë notën mesatare të paktën 8.00;
- Të ketë statusin e njëjtë social.

8.7. Nëse numri i kandidatëve të paraqitur për bursë sociale e kalon numrin e caktuar me vendim nga Bordi Drejtues i Kolegjit, atëherë do të organizohet testi vlerësues.

Neni 9

Nëse studenti përfitues i bursës sociale gjatë vitit të parë të studimeve nuk tregon rezultate të shkëlqyeshme dhe sillet në kundërshtim me rregullat e brendshme të Kolegjit, do të humb bursën për vitet pasuese.

Neni 10

Kriteret për bursë për persona me aftësi të kufizuara

9.1. Kolegji mbështet kategoritë të cilat janë me nevoja të veçanta. Këto kategori përcaktohen me ligje vendore.

9.2. Ndarjen e bursave për këto kategori dhe politikat për ndarjen e bursave të tilla e përcakton Bordi Drejtues i Kolegjit me vendim të posaçëm.

9.3. Për ndarjen e bursave për këto kategori, Bordi Drejtues i Kolegjit nënshkruan marrëveshje bashkëpunim me shoqatat që përkujdesen për mirëqenien e tyre.

9.4. Në marrëveshje përcaktohen edhe kushtet dhe kriteret e ndarjes së bursave.

Neni 11

Bursat parciale (të pjesshme)

11.1. Kolegji duke marrë parasysh rrethanat e caktuara, në vend të bursave të plota mund të ndajë bursa parciale.

11.2. Bursat parciale do të ndahen në përqindje të caktuara, sipas rasteve përkatëse.

III – PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES

Neni 12

12.1. Përzgjedhjen e kandidatëve, të cilëve do t'iu mundësohet shkollimi falas (bursë) universitare e bën komisioni i formuar nga Bordi Drejtues i cili përbëhet prej 3 anëtarësh.

12.2. Komisioni do të bëjë testimin dhe organizimin provimit me gojë.

12.3. Kandidatët më të suksesshëm i rekomandohen Bordit Drejtues për aprovim dhe miratim.

12.4. Bordi Drejtues merr vendim për ndarjen e bursave.

12.5. Lista e përfituesve të bursave shpallet në tabelën e shpalljeve të Kolegjit.



Neni 13

Pas përzgjedhjes së kandidatëve bursistë, studenti obligohet të nënshkruaj kontratë me Kolegjit, me të cilën kontratë caktohen të drejtat dhe detyrimet reciproke.

IV. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT E PËRFITUESIT - BURSISTIT

Neni 14

14.1. Përfituesi i shkollimit falas (bursistit) obligohet:

- të ndjekë ligjëratat, ushtrimet seminarët si dhe aktivitete tjera mësimore sipas planprogramit dhe orarit të përcaktuar nga Kolegji;
- të tregojë vëmendjen e duhur ndaj të drejtave të personelit dhe studentëve të tjerë;
- të respektojë afatet e provimeve sipas orarit të përcaktuar nga Kolegji.
- të jetë i disiplinuar gjatë kohës së kaluar në mjediset e Kolegjit;
- të respektojë Kodin Etik të studentëve;
- të respektojë stafin e Kolegjit dhe të silllet me ndershmëri akademike dhe disiplinore;
- të silllet si ekonomist i mirë me asetet e Kolegjit, etj.

Neni 15

Përfituesi i shkollimit falas (bursës) e humbë të drejtën për studime në Kolegjin nëse vepron në kundërshtim me aktet e brendshme normative të Kolegjit (Statutit, Rregulloret dhe Kodit të Mirësjelljes) si dhe nuk iu nënshtron provimeve në afat të rregullt dhe nuk tregon suksese dhe interesim për studime.

V. PROCEDURA ANKIMORE

Neni 16

16.1. Kundër vendimit të Bordit Drejtues lejohet paraqitja e kërkesës për rishqyrtim të vendimit.

16.2. Kandidati i pakënaqur me vendimin e Bordit, mund të paraqesë kërkesë për rishqyrtim të vendimit brenda afatit prej 48 orësh nga shpallja e listës së përfituesve të bursave. Në kërkesë, kandidati paraqet themelet e kundërshtimit të vendimit.

16.3. Bordi Drejtues do ta shqyrtojë kërkesën brenda afatit prej 72 orësh dhe do të shpallë listën përfundimtare me fituesit e bursave.

16.4. Bordi vendos me shumicë votash të të gjithë anëtarëve të vet.

16.5. Kundër vendimit të Bordit nuk lejohet paraqitja e ankesës.



Neni 17

15.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi Drejtues dhe nënshkrimit nga Presidenti i Bordit i Kolegjit "Pjetër Budi" - Prishtinë.

15.2. Më hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet rregullorja e vjetër që rregullon të njëjten çështje. Prishtinë,

**Presidenti i Bordit
Besim AJETI**